




**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



Nr. 306/16  
Data. 20.07.2016

Prishtinë, 23 qershor 2016  
Kodi i ZRRE-së: V\_834\_2016

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

Bazuar në:

- Dispozitat e Neneve 14 dhe 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë,
- Dispozitat e Nenit 22 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë,
- Dispozitat e Nenit 18 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit,
- Kërkesën e KQKO për amendamentimin e Kodit të punës për qasje në Tokë dhe Ndërtesa të datës 23 shtator 2015,

në seancën e mbajtur me datë 23.06.2016, nxori këtë:

**V E N D I M**

- I APROVOHET** amendamenti i dokumentit “**Kodi i punës për qasje në Tokë dhe Ndërtesa**” të KOSTT Sh.a., si në shtojcë të këtij vendimi.

**Arsyetim**

- o Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 14.09.2015 ka pranuar kërkesën e KQKO për amendamentimin e Kodit të punës për qasje në Tokë dhe Ndërtesa. Në këtë kuadër janë bërë përshtatje të dispozitave ligjore dhe rregullative të legjislacionit në fuqi, riformulime të fjalive, përmirësime gjuhësore dhe rregullime të tekstit.
- o ZRRE ka dhënë komente gjatë periudhës amendamentuese si pjesëmarrëse aktive në KQKO.
- o Pas këtyre zhvillimeve, KQKO ka amendamentuar dokumentin në harmoni me ndryshimet, dhe me datë 23.09.2015 ka bërë kërkesë zyrtare në ZRR E për Aprovimin e amendamentimit të Kodit të punës për qasje në Tokë dhe Ndërtesa.
- o Pas vlerësimit të kërkesës, ZRRE ka parë të arsyeshme që të lejojë amendamentimin e Kodit të punës për qasje në Tokë dhe Ndërtesa.




- Të gjitha dispozitat tjera të Kodit të punës për qasje në Tokë dhe Ndërtesa do të mbesin në fuqi.
- II Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- III Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE - së.


**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.


Shtojcë: Kodi i punës për qasje në Tokë dhe Ndërtesa i amendamentuar.


- Vendimi i dërgohet:
  - Të licencuarit KOSTT Sh.A.
  - Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

**Bordi i ZRRE-së**

  
Enver Halimi, kryesues

  
Krenar Bujupi, anëtar

  
Arsim Janova, anëtar

  
Qemajl Mustafa, anëtar

  
Besim Sejfiqaj, anëtar



**KODI I PUNËS**

**PO-KO-011**

*ver. 1.1*

*faqe 1 nga 18*

**KODI I PUNËS PËR QASJE NË TOKË DHE  
NDËRTESA**

**Prishtinë  
Qershor 2015**

